VENDIM
Nr.1293, datë 29.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

(Ndryshuar me VKM nr. 736, datë 8.9.2010; nr. 64, datë 26.1.2011)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 130, datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e *Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit* kryetar të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:

a) znj. Majlinda Bregu, Ministre e Integrimit;

b) z. Nasip Naço, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

c) z. Ferdinand Poni, zëvendësministër i Brendshëm;

ç) z. Nezir Haldeda, zëvendësministër i Financave.

3. Vendimi nr.688, datë 18.6.2009 i Këshillit të Ministrave "Për emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të FSHZH-së", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha